



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OFŠTINA VUÇITRNI	
01 Nr. / Br	111/20
Nr. i fq. / Br. et	- 7 -
Data: / Datum	25.06.2020



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

NGA MBLEDHJA URGJENTE E -VII-të ME RADHË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 10 QERSHOR 2020

Mbledhja është mbajtur në objektin e Shkollës së Mesme Gjimnazi "Eqrem Çabej" në Vushtrri, duke filluar në orën 10:30.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Abdullah Vojvoda, Ali Januzi, Agron Perçuku, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Fitim Halili, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rustemi, Shkëlzen Feka, Safet Idrizi, Melihate Basholli-Latif, Suzana Syla Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Hysni Gërguri, Agim Bregaj, Shpëtim Zhegrova dhe Miljan Bojković.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Xhafer Tahiri, nënkyetari i komunës z. Besim Muzaqi, drejtori i drejtoreve komunale dhe zyrtar kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 31 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes përmarrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishmit mbajtën një minutë heshtje për ish – kryetarin e komunës së Vushtrrisë, Jahja Abazi, i cili ndërroi jetë ditë më parë,

Kuvendi i Komunës njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për rishikimin e Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020;
2. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për rishikimin e Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- ne si deputetë jemi para një sfide bukur të vështirë përfaktin se asnjëherë nuk ka pasur kësos praktika që nga kategoria e pagave dhe mëditjeve të kërkohet që të bëhet rishikimi i buxhetit dhe të barten në kategoritë tjera. Ai tha se nuk është i sigurt nëse drejtoria gjegjëse është konsultuar me Ministrinë e Financave. Por, një e di që asnjëherë nuk është lejuar që të bëhet bartja nga kategoria e pagave, sepse është kategori e veçantë, e cila është e destinuar për çdo organizatë buxhetore që t'i paguajë të punësuarit e vet, ku është i caktuar edhe numri i punëtorëve dhe se caktohet granti për atë kategori, tha Azemi.

Kemi potencuar disa herë që çdo vit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve kanë shkuar suficit 350-360 mijë euro, përfaktin se qeveria komunale nuk ka hapur konkurse për t'i plotësuar vendet e punës të cilat janë të planifikuara.

Azemi theksoi se përveç kërkësës përbartje të mjeteve, edhe destinimi nuk është i arsyeshëm dhe nuk është në pajtim me planifikimet buxhetore, sepse nuk kërkohet që të plotësohet një program i caktuar investiv (infrastrukturor), por kërkohet që këto mjetë të shkojnë në infrastrukturën publike për Covid 19. Kjo kërkësë është sfiduese, sepse bartim përgjegjësi, pasi që bëhet fjalë për një vlerë të madhe. Lidhur me këtë jam i bindur sepse nuk do të mund t'i justifikojnë dhe as nuk do të mund t'i arsyetojnë shpenzimet nëse ndodhë ky rishikim i buxhetit, tha Azemi. Kjo është një parapërgatitje përtak krijuar një vijë të buxhetit përanaliza. Ai tha se qëllimi dhe dëshira jonë kishte me qenë që me i shty proceset dhe vazhdimisht do të kontribuojmë në atë drejtim, por në rastin konkret nuk jam i bindur se është qëllimi i duhur dhe se është në pyetje interesit publik.

Ai kërkoi sqarime nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Bahrije Ademi Murati, anëtar e kuvendit- theksoi se janë të shqetësuar lidhur me këtë seancë kaq urgjente. Duke pasur parasysh se instruksionet nga Ministria e Financave kanë ardhur me datën 5 qershor, është e pa justifikueshme si të thirret seancë ditën e fundit të përfundimit të afatit, saktësisht 17 orë para seancës. Prandaj, në bazë të kësaj kohe aq të shkurtër, nuk kemi pasur kohë përsqarime me njëri – tjetrin. Secili nga ne kemi përgjegjësi morale para qytetarëve që na kanë sjellë këtu që ta dinë në detaje se ku do të destinohen mjetet dhe a po dëmtohen linjat buxhetore me rishikim e bartje për Covid 19.

Kërkojmë nga Drejtoria e Financave që të na sqaroj në detaje këtë çështje, pasi që bëhet fjalë për një shumë financiare prej 300 mijë euro nga buxheti që e mbushin vet qytetarët.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-tha se është e vërtetë që rishikimi i buxhetit sipas ligjit thotë që është harmonizimi i kategorive brenda kategorive, por edhe më herët kemi pasur raste që nga kategoria e kapitaleve i kemi shndërruar në mallra dhe shërbime. Ne kemi bërë një analizë dhe te kategoria e pagave dhe mëditjeve kemi suficit të buxhetit, gjë që mund të na humbin. Prandaj, po dëshirojmë t'i destinojmë përkëtë qëllim. Si dhe në Drejtori të

Bujqësi i kemi 100mijë te projektet me bashkëfinancim, ku qëllimi është që këto mjete t'i shfrytëzojmë për studimin e pasojave nga Covid 19.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-theksoi se fillimi ishtë kemi menduar të mos bëjmë fare rishikim. Por, dje ishin në një takim me kryetarët e komunave dhe u dakordua shumica që ta dërgojmë në këtë formë. Kurse, sot në ora 15:00 kemi takim me ministrin e financave. Ai tha se pasojat e pandemisë Covid 19 do të zgjasin, ku jemi dëshmitarë se po kemi rikthim të rasteve në komunën tonë. Tahiri deklroi se Qeveria e Kosovës i kompenzon mjetet për Covid 19 vetëm nëse mjetet financiare vendosen në kodin 00099 që është i dedikuar për Covid 19.

Sa i përket kategorisë së pagave, secili nga ne kemi dëshirë që sa më shpejtë t'i kemi profesionistët në komunë.

Tahiri tha se sot do ta ngrisin në qeveri si shqetësim, që pakoja emergjente që u është ndarë punëtorëve është marrë nga buxheti i komunave. Me një fjalë qeveria ka bërë nder me para të komunave. Nuk jam kundër që u janë ndarë mjetet, por është dashur që të na njoftojnë dhe nderin t'ua lënë komunave.

Ai tha se jemi në vështirësi financiare për shkak të pagave të mësimdhënësve, ku këtë vit na kanë dëmtuar 680mijë euro.

Ne po planifikojmë që ta bëjmë një studim të madh, i cili nuk është vetëm për këtë kohë, por do të jetë së paku edhe për dhjetë vitet e ardhshme baza e çdo politikbërje e Vushtrrisë. Do ta bëjmë një studim të thellë të gjendjes ekonomike në Vushtrri dhe do t'i përgatisim së paku 20 projekte për aplikim te donatorët për sanimin e gjendjes ekonomike, tha Tahiri.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit- tha se nuk mora sqarime nga drejtori i financave. Po kërkoi që së paku në vija të trasha të na jep sqarime se a është planifikuar paraprakisht që kjo shumë financiare prej 300 mijë euro për çfarë do të shfrytëzohet. Ne jemi që ta përkrahim këtë, por po kërkojmë sqarime se për çfarë konkretisht do të shfrytëzohen këto mjete. Pra, a ka ndonjë planifikim?

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se është shqetësues fakti i thirrjes kaq me urgjencë të kësaj mbledhje brenda një afati prej shtatëmbëdhjetë orësh, për rishikimin e buxheti, kur dihet fakti se instrukzionet nga Ministria e Financave për rishikim buxhetor janë dërguar në komunë më datën 5 qershor 2020. Një nguti e tillë bënë që sot të votohet një vendim për rishikim të buxhetit pa u analizuar si duhet. Tutej shtoi se disa komuna të Kosovës, kanë bërë rishikimin e buxhetit, por se rishikimi është bërë në aspektin e disa projekteve tjera në të mirë të qytetarëve a jo vetëm sa i përket pandemisë covid -19. Andaj ajo pyeti kryetarin e komunës se a është fjala vetë Komuna e Vushtrrisë që po bënë rishikimin e buxheti në aspektin e kodit ekonomik sa përket studimit të pandemisë covid-19.

Melihatet Basholli-Latifë, anëtare e kuvendit-tha se kjo mbledhje e kuvendit është dashur të mbahet më herët ashtu që anëtarët e kuvendit të kenë kohën e duhur për ta analizuar mirë çështjen e rishikimit të buxhetit. Tutje kërkoi sqarime për se cilin projekt i cili do të ndryshohet si dhe bartja e mjeteve financiare në cilat projekte po bëhet. Kjo për faktin se shihen mjetet financiare por nuk shihen projektet në cilat po barten ato mjete. Është paradoksal që nga Drejtoria e Kulturës të merren 35, 000.00 €, kur dihet se kjo drejtori është ndër drejtoritë me buxhet më të limituar, ndërsa në drejtorit tjera të merren më pak mjete. Ajo vlerësoi se kulturës në komunën tonë duhet ti jepet prioritet i merituar sepse ajo e mban gjallë shpirtin krijues të qytetarëve. Sa i përket studimit të fizibilitetit të pandemisë covid-19 mendon se kjo duhet të bëhet në nivel shtetëror, dhe shtroi nevojën që me këto mjete të ndihmohen bizneset të cilat janë në falimentim e sipër si pasoj e pandemisë. Lidhur me pagat jubilare dhe shpenzimet e mësimdhënësve kërkoi nga kryetari i komunës që mos ti atakoj ata, duke u thirrur në dëmtimin e

buxhetit të komunës për shkak se janë pikërisht mësimdhënësit të cilët janë dëmtuar më së shumti në të kaluarën.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se është dakord që të përkrah të gjitha projektet e komunës që janë në mirën qytetare, pasi vërtet Komuna e Vushtrrisë është duke kaluar një gjendje të rënd për shkaka të pandemisë covid-19. Mirëpo në rastin konkret ai propozoi që të bëhet riformulimi i propozim-vendimit për rishikim të buxhetit si në vijim: mjete financiare të cilat po barten 10 % e tyre mund të përdoret për financimin e studimit të fizibilitetit të gjendje ekonomike të komunës dhe ndikimin e pandemisë covid-19, ndërsa pjesa tjetër të përdorën për nevojat tjera të qytetarëve të cilat i identifikon komuna, për pako ushqimore, higjenike dhe dezinfektim të objekteve si dhe nevoja tjera emergjente si pasoj e pandemisë covid-19.

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së-sqaroi se mjete financiare të rishikuara, do të shfrytëzohen për studimin e fizibilitetit të ekonomisë së komunës por edhe për nevojat tjera të qytetarëve si pasoj e pandemisë covid-19. Tështo se projektet kapital nuk janë prekur me përjashtim të një projekti në bashkëfinancim nga lëmi i bujqësisë, ndërsa në Drejtore të Kulturës mjetet barten nga kategoria e pagave dhe mëditjeve të cilat do të shkonin në suficit.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-sqaroi se asnjëherë dhe në asnjë rrethanë nuk i ka fajësuar dhe nuk do ti fajësoj mësimdhënësit për të drejta e tyre të cilat iu takojnë sipas ligjit, lidhur me pagat jubilare dhe shpenzimet për shujta dhe udhëtim. Pastaj ai njoftoi se vitin e kaluar komuna i ka planifikuar në listat e pagave shpenzimet për paga jubilare dhe shpenzimet tjera por që këto pagesa nuk janë kryer nga Ministria e Financave. Tështo se rishikimi i buxhetit po bëhet dhe mjetet financiare po barten në projektin me kod ekonomik 00099 infrastrukturë publike lidhur me covid-19, dhe nga ky fond do të financohen nevojat e qytetarëve si rezultat i pandemisë covid-19, por që komuna mëton që këto mjetet ti rimburësohen nga Qeveria e Kosovës. Në fund ai bëri thirrej që më maturi politike dhe në mënyrë racionale të analizohet dhe vlerësohet ky propozim-vendim dhe i njëjtë të aprovohet nga ana e kuvendit.

Bahrije Ademi, Murati, anëtare e kuvendit-në emër të grupit kuvendar të LVV-së, propozoi që mjetet financiare të bartën për menaxhimin e pandemisë covid-19 dhe jo për studim të fizibilitetit.

Faton Shabani, anëtar i kuvendit-tha se me këtë rishikim nuk dihet se cilat projekte do të financohen, përpos që përmendet fizibiliteti lidhur me pandeminë covi-19, dhe ajo se çfarë po kërkohet nga anëtarët e kuvendit është që 80 % e këtij buxheti të dedikohet për dezinfektim, pako ushqimore dhe gjëra tjera që kanë inpakt kryesor me sanimin e pasojave të pandemisë covid-19. Tështo se ajo çfarë po kërkon qeveria komunale është se të barten mjetet financiare sipas kërkësës së tyre e pastaj ata veprojnë si të dëshirojnë vetë, por jo kështu nuk do të votojnë, pa pasur sqarim dhe planifikim të saktë të projekteve.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se ideja e kësaj bartej të mjeteve sipas logjikës së shpenzimit të buxhetit është që shumat e shpenzuar për menaxhimin e covi-19 të mbulohen nga qeveria e Kosovës.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-pyjeti kryetarin e komunës se a ka biseduar me ndonjë kompani kontraktuese lidhur me hartimin e projektit për studimin e fizibilitetit për pandeminë covid-19.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-në përgjigjen e tij ceku se ai nuk bisedon me kompani private për të lidhur ndonjë punë kontraktuese sepse kjo gjë bie në kundërshtim me ligjin, por e vërteta është Drejtoria e Ekonomisë ka marrë iniciativën për zhvillimin e këtij studimi dhe tanë i mbetet Drejtorisë së Prokurimit që zhvilloj këtë projekt përmes procedurave tenderuese. Pastaj vlerësoi se nëse ne e presim qeverinë qendrore që ta bëj zhvillimin e studimit të ndikimit të

covid-19 atëherë komuna do të ngel prapa sepse një gjë të tillë qeveria nuk e bënë, pasi që koi çështje bie në domenin e kompetencave komunale si njësi administrative e qeverisjes lokale në Kosovë. Në anë tjetër ai nënvizoi se studimi i ndikimit të pandemisë në jetën ekonomike të komunës është i nevojshëm e mbase i domosdoshëm për ta parë e për ta përshkruar në letër gjendjen në të cilën ndodhemi si komunë. Ai vlerësoi se deri më tanë pandemia covid-19 është menaxhuar mirë, por rritja e rasteve ka ndodhur si rezultat i vizitave gjatë festës së Fitër Bajramit duke pasur infeksion në familjet e mëdha e mandej shpërthimi nëpër lidhjet farefisnore.

Faton Shabani, anëtar i kuvendit-tha se nëse mendohet që 300,000.00 € të shfrytëzohen për studimin e fizibilitetit për pandeminë, atëherë më mirë është kjo mos të bëhet fare pasi që më tepër do të shkaktoj pasoja ky studim fizibiliteti se sa vetë pandemia covid-19. Në anë tjetër ai vlerësoi se pandemia akoma nuk ka përfunduar dhe mjetet financiare janë tepër të nevojshme, ndërsa studimi i fizibiliteti mund të bëhet në të ardhmen e afërt apo vitin tjetër sepse nuk është gjë imediate për komunën. Shpenzimi i gjithë këtyre mjeteve për këtë studim, po i bie që mi i kushtueshëm të jetë ky studim se sa vetë pandemia.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të LDK-së e mbështeti propozim-vendimin për rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2020, duke vlerësuar se hartimi i një studimi të fizibilitetit për ndikim të pandemisë covid-19 në ekonominë e komunës është tepër i nevojshëm.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se mjetet financiare të cilat po barten po merren tek fondi me bashkëfinancim në bujqësi gjë për të cilën nuk kemi siguri që deri në fund të viti do të kemi investim nga donatorët, dhe pjesa tjetër po bartet nga kategoria e pagave të cilat do të shkonin në suficit buxhetor në buxhetin e Kosovës, andaj zgjidhja më e mirë është që ato barten tek kodi ekonomik 00099 covid-19, më qëllim që shfrytëzohen për nevojat e menaxhimit të pandemisë dhe që ato të kompensohen nga qeveria e Kosovës më vonë.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit-pyeti se në cilat projekte do të shkojnë këto mjete dhe a është ligjore bartja e këtyre mjeteve. Pastaj shtoi se nëse këto mjetet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve nuk barten atëherë ato do të shkojnë në suficit buxhetor dhe komuna do ti humb ato. Tutje shtoi se nëse këto mjete nuk shpenzohen deri në fund të vtitit dhe ato shkojnë rrjedhimisht në suficit, atëherë cili është interes i që ato mos të barten. Këto mjete më mirë do të ishte që të rishikohen si pozicione dhe të shfrytëzohen për menaxhimin e pandemisë covid-19 dhe financimin e nevojave tjera për qytetarët në këtë periudhë kaq të rënd për qytetarët.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-duke ju referuar vendimit të kuvendit për alokimin e mjeteve financiare në vlerë prej 200,000.00 € për nevojat e pandemisë covid-19, pyeti se sa prej atyre mjeteve janë shpenzuar, ku janë shpenzuar dhe a kemi ende fond nga ato mjetet të cilat janë ndarë. Ai vlerësoi se fokusi kryesor duhet të jetë luftimin e pandemisë covid-19, pasi që ky virus akoma është prezent në mesin tonë e mbase në formë mjaft të fuqishme ai po shkakton vatra të reja infeksioni, e jo të flitet këtu sikur gjithçka ka përfunduar dhe tanë po marrim masa sepse kjo nuk është kështu në realitet. Më tej shtoi se nuk është mirë që mjetet në vlerë të madhe të shpenzohen për fizibilitet, pasi që pandemia akoma nuk ka kaluar dhe është tepër e nevojshme që këtë mjete të shfrytëzohen në mënyrë racionale në adresimin e nevojave dhe kërkeseve të qytetarëve gjatë kësaj periudhe të rënd që po kalon komuna si pasoj e pandemisë. A kërkoi që të ketë pauzë prej 5 minutash që të ketë harmonizim të qëndrimeve mes shefave të grupeve kuvendare.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se edhe në të kaluarën por edhe tanë gjithherë kur kemi marrë vendime të shpejta gjithherë kemi gabuar, ai ceku se nuk është kundër kur është në pyetje

interesi qytetar, por kuvendi nuk i mori sqarimet e duhura para votimit të këtij propozim-vendimi.

Besim Muzaqi, nënkyrytar i komunës-tha se sa herë që bisedojmë e sidomos në relacionet kur kemi shpenzim të parasë publike ato debate janë produktive e të mirëseardhura. Pastaj shtoi se sqarimet nuk ishin të mjaftueshme nga ana e drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit, dhe kjo bërë që kjo çështje të mos shoshitet ashtu si duhet deri në fund. Megjithëkëtë duke u bazuar në instruksionin e Ministrisë së Financave shtrohet nevoja që të bëhet rishikimi i buxhetit të komunës me theks të veçantë për financimin e masave sa i përket menaxhimit të pandemisë covid-19. Andaj konfom këtyre është e drejtë ligjore e komunës që ndërmarr veprim për të lidhur kontrata për marrje shërbimesh në rastin tonë për studim fizibiliteti, por duke shikuar se sa është i leverdishëm ai shërbim dhe jo që mjetet të jepen ashtu apriori, andaj ai vlerësoi se është mirë që këto mjete të bartën, ashtu që të shtrohet rruga që komuna të bëjë kërkësë për rimbursimin e këtyre mjeteve nga Qeveria e Kosovës.

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së-njoftoi se sufici i kategorisë e pagave, është vetëm për gjashtëmujorin e parë, ndërsa për gjashtëmujorin e dytë është ruajtur fondi i pagave duke përfshirë edhe vendet e lira, andaj përsërit se nëse deri më datë 30 qershori nuk shpenzohen këto mjete atëherë këto mjete shkojnë në suficit dhe merren nga Qeveria e Kosovës.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 28 vota “për” 3 vota “abstinen” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet rishikimi i buxhetit të komunës për vitin 2020, sipas kategorive dhe fondit si në vijim:

1.1 Nga Fondi 10, Kategoria Paga dhe Mëditje, nga programet:

Zyra e kryetarit, kodi 16024, shuma.....	(15,000.00€)
Administrata, kodi 16324, shuma.....	(21,000.00€)
Zyra e kuvendit komunal, kodi 16924, shuma.....	(15,000.00€)
Buxheti, kodi 17524, shuma.....	(25,000.00€)
Infrastruktura publike, kodi 18184, shuma.....	(5,000.00€)
Menaxhimi i fatkeqësive natyrore, kodi 18468, shuma.....	(5,000.00€)
Zyra lokale e komuniteteve, kodi 19620, shuma.....	(5,000.00€)
Bujqësia, kodi 47024, shuma.....	(15,000.00€)
Shërbimet kadastrale, kodi 65120, shuma.....	(15,000.00€)
Planifikimi, urbanizmi, inspektimet, kodi 66425, shuma.....	(10,000.00€)
Administrata, kodi 73033, shuma.....	(5,000.00€)
Shërbimet sociale, kodi 75616 shuma.....	(8,000.00€)
Shërbimet rezidenciale, kodi 75617, shuma.....	(11,000.00€)
Shërbimet kulturore, kodi 85024, shuma.....	(35,000.00€)
Administrata, kodi 92120, shuma.....	(10,000.00€)

2. Shuma e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij vendimi bartën në fondin e njëjtë, në kategorinë mallra dhe shërbime, në programin infrastruktura publike, kodi 18184 Covid-19 (00099), shuma 200,000.00€.

3. Mjetet financiare nga fondi 10, kategoria investime kapitale, programi 47024 - Bujqësia, projekti me kod 49549 "Projektet në bujqësi me bashkëfinancim", shuma e mjeteve financiare (100,000.00€) barten në fordin e njëjtë në kategorinë mallra dhe shërbime, në programin infrastruktura publike, me kod 18184 Covid-19 (00099), shuma 100,000.00€.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:08.

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit

